

VENDIM
Nr. 38, datë 5.10.2023

PËR MIRATIMIN E PËRQINDJES SË PAGESËS RREGULLATORE

Në mbështetje të nenit 10, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji 8102); të nenit 9, të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (VKM-së nr. 539); “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura” (Rregullore); si dhe në vijim të analizës së prezantuar nga DSHM-ja për nevojën e rritjes së të ardhurave nga pagesat rregullatore për mbështetje financiare të ERRU-së, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të aplikohet koeficienti 0.77% mbi të ardhurat e vitit paraardhës për llogaritjen e pagesës rregullatore për të gjithë operatorët me efekte nga data 1.1.2024.
2. Ndjekin dhe përgjigjen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Tekniko-Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
3. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 485, datë 14.10.2022, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani